



Prishtinë: 18.09.2008

Kodi i ZRRE-së: V_123_2008

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_R_115_09_08

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK_R_115_09_08; dhe
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Në mbledhjen e mbajtur më 18 shtator 2008 nxori këtë:

VENDIM

PRANOHET ankesa e konsumatorit Ismalj Meshekran (shifra e konsumatorit DPR – 90010397) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK në ZRRE me datë 09.05.2008 ka apeluar përgjigjen e KEK – Divizionit të Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 09.05.2008, lidhur me ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar.

- Me datë 02.03.2006 ekipi i autorizuar i KEK-ut ka bërë ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 10041663 dhe ka vendosur njehsorin elektrik nr. 37398749.

Provë: Vërtetim mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik të datës 02.03.2006

- Me datë 11.05.2007 ekipi i autorizuar i KEK-ut ka bërë ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 37398749 dhe ka vendosur njehsori elektrik nr. 44057626.

Provë: Vërtetim mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik të datës 11.05.2007

- Me datë 12.06.2007 Sektori i kalibrimit, leximit dhe matjes në KEK ka bërë kontrollimin detal të njehsorit me anë të procesverbalit nr. 11/12 ku është konstatuar se bllobat shtetërore dhe numëruesi janë të manipuluar.

Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 11/12 të datës 12.06.2007



- Me datë 28.01.2008 ekipi i autorizuar i KEK-ut ka dalur në vendin e ngjarjes tek konsumatori dhe ka regjistruar profilin e kablos me anë të cilin është furnizuar njehsori i konsumatorit

Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 0104721 i datës 28.01.2008

- Me datë 05.03.2008 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR08HP04894 në shumë prej 2,580.05 €.

Provë: Fatura e KEK-ut DPR08HP04894 e datës 05.03.2008

- Konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar.

Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK

- Me datë 09.05.2008 Departamenti për Konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në procesverbalin e ekipit të kontrollës nr. 0104721 të datës 09.05.2008.

Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 09.05.2008

- Me datë 09.05.2008 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.

Provë: Ankesa e konsumatorit

- Me datë 20.05.2008 me kërkesën e konsumatorit DMK në ZRRE ka organizuar një takim në KEK ku është kërkuar nga Qendra e Kalibrimit të bëhet rihapja dhe rishqyrtimi i njehsorit elektrik. Me këtë rast gjatë rishqyrtimit të njehsorit elektrik të konsumatorit nga njësitë i kalibrimit nën vëzhgimin e komisionit (DMK, KEK, Konsumatori) nuk janë dëshmuar konstatimet për abuzim të paraqitura në raportin e datës 12.06.2007.

Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 8/20 i datës 20.05.2008

DMK në ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEK-ut ka vërejtur se:

- ✓ Procesi i njësitit të kalibrimit i datës 12.06.2007 Nr. 11/12 ka pasaktësi dhe si i tillë nuk mund të merret për bazë për ta ngarkuar konsumatorin për abuzim të pikës matëse.

Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 8/20 i datës 20.05.2008

- ✓ Sipas analizës së bërë shpenzimit të energjisë elektrike të konsumatorit me njehsor të vjetër dhe njehsor të ri gjatë sezonës së dimrit vërehet se konsumatori me njehsor të vjetër ka qenë duke shpenzuar më shumë energjisë elektrike se sa me njehsor të ri.

Provë: Transaksionet e konsumatorit



- ✓ Komisioni i cili ka marrë pjesë në rihapjen dhe rishqyrtimin e njehsorit elektrik nuk kanë vërejtur se konsumatori ka bërë ndonjë manipulim me njehsorin elektrik.
- ✓ KEK-u ka gabuar në llogaritjen e ngarkesës për shfrytëzim të paautorizuar ngase njehsori i cili sipas KEK-ut është konstatuar si i manipuluar është vendosur në periudhën 03/2006 dhe është hequr në periudhën 05/2007 ndërsa KEK-u sipas faturës për shfrytëzim të paautorizuar e ka ngarkuar me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar duke u kthyer mbrapa për 24 muaj që nuk ka pasur të drejtë ngase njehsori ka qenë i vendosur vetëm 14 muaj.

Provë: Vërtetimet e ndërrimit të njehsorëve të datës 02.03.2006 dhe 11.05.2007.

DMK në ZRRE pas analizimit të dëshmimeve të paraqitura rekomandon Bordit të ZRRE-së që të **pranon** ankesën e konsumatorit.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur që ta **pranojë** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së. Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që

1. Të shkarkoj konsumatorin nga ngarkesa për shfrytëzim të paautorizuar fatura DPR08HP04894 në shumë prej 2,580.05 €

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente të Prishtinës, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së:

Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Nysret Avdiu, anëtar